

KOMUNA E KLINËS

RREGULORE KOMUNALE
PËR EKSPLOATIMIN E BURIMEVE TË MINERALEVE
(E harmonizuar me 31 mars 2004)

Klinë, 03 maj 2002

Në pajtim me Rregulloren për vetëqeverisjen lokale të komunave të Kosovës, nr.2000/45, të 11 gushtit 2001, Rregulloren për Ligjin e aplikueshëm në Kosovë, nr. 1999/24 të 24 dhjetorit 1999, nenit 92 al. 3. të Statutit të Komunës së Klinës, Kuvendi Komunal në seancën e vetë të rregullt të IV me radhë, të mbajtur, më datën 30 prill 2002, aprovoi këtë:

RREGULLORE KOMUNALE PËR EKSPLOATIMIN E BURIMEVE TË MINERALEVE

Me qëllim të rregullimit dhe përforcimit të procedurës përkatëse lidhur me eksploatimin e burimeve minerale.

Duke rikujtuar çështjen e mbrojtjes së ambientit,
Duke pasur parasysh çështjen e zhvillimit rural si dhe,
Duke rikujtuar Ligjin e aplikueshëm në Kosovë.

Definicionet / përcaktimet

Neni 1

Në zbatim të kësaj Rregulloreje, termet e mëposhtme janë të përkufizuara siç vijon:

- 1.1 **Burimet e mineraleve:** Sikurse definohen në nenin 10.1 të DAL/Udhëzimi administrativ, Nr. 2001/02 dhe Udhëzimi administrativ të AQF-së, Nr. 2001/03 Impelmentuese e Rregullores së UNMIK-ut, Nr. 2000/45, të 11 gushtit 2000, për Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës.
- 1.2 **Studimet-hulumtimet:** Referojnë paraprakisht hetime gjeologjike, mineralogjike, gjeokimike dhe gjeofizike për të përcaktuar se a ka potencial të përmbajtjes së burimeve të mineraleve në atë sipërfaqe.
- 1.3 **Autorizimi (leja) për hulumtim:** Do të thotë autorizimi për organizatën për të bërë hulumtime, të cilat nuk duhet të përmbajnë ndonjë shpim, gjermim, gropim ose aktivitete tjera, të cilat mund ta çrregullojnë sipërfaqen, në zonën e caktuar për kohëzgjatje të caktuar.
- 1.4 **Eksplorimi (kërkimi) :** I referohet hetimeve mineralogjike, gjeokimike dhe gjeofizike, (përfshirë edhe shpimet, gjermimet, gropimet), të cilat mendohen ta përmirësojnë cilësinë, sasinë, pozitën, formën dhe kushtet për kërkimin e burimeve të mineraleve.
- 1.5 **Leja për eksplorim (kërkim):** Do të thotë autorizim ekskluziv për organizatën e cila bën kërkimet në një zonë të caktuar për kohëzgjatje të caktuar.
- 1.6 **Eksplorimi:** I referohet nxerrjes, përgatitjes dhe përpunimit të burimeve të mineraleve përfshirë konstrukcionimin e të gjitha paisjeve, uzinave, instalimeve nëntokësore dhe sipërfaqësore të kërkuesve për ta ndërmarrë këtë punë.
- 1.7 **Leja për eksploatim:** Do të thotë autorizim ekskluziv për organizatën për të ndërmarrë eksploatimin e mineraleve në zona të caktuara dhe me kohëzgjatje të caktuar.

- 1.8 **Leja e përkohëshme për eksploatim:** Do të thotë eksploatim, i cili është lëshuar fillimisht për një kohë të caktuar gjatë secilës kohë nga bartësi është kërkuar që të ndërmarrë punë specifike.
- 1.9 **Për qellime artizane:** Do të thotë eksploatimi i burimeve të mineraleve për nevoja personale, por pa ndonjë përfitim ekonomik në secilën formë apo trajtë.

Procedura

Neni 2

- 2.1 Nuk lejohet heqja apo largimi i asnjë burimi të mineraleve pa leje apo autorizim përkatës të lëshuar nga autoritet kompetente.
- 2.2 Drejtorati për Miniera dhe Minerale në Prishtinë duhet të lëshojë leje dhe leje të përkohshme për eksploatim dhe eksplorim.
- 2.3 a). Çdo posedues i autorizimit për zbulim/gjurmim, i cili gjen rezerva potencialisht të vlefshme në të njejtën zonë për të cilën i është lëshuar leja do të jepet licenca për eksploatim nëse propozimi i tij është i pranueshëm për Drejtoratin për Miniera dhe Minerale.
- b). Çdo posedues i lejes për eksploatim, i cili gjen rezerva në zonë dhe përgatit studime të caktuara për ta përshkruar zhvillimin e rezervave do të jepet licenca nëse propozimi i tij është i pranueshëm për Drejtoratin për Miniera dhe Minerale.
- 2.4 Në mënyrë që të lëshohet licenca e përkohshme për eksploatim ose eksplorim, së pari duhet të aplikohet për autorizimin lidhur me zbulimin(hulumtimin)në Drejtoratin për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Ambient të Komunës.
- Nëse Drejtorati aprovon autorizimin,atëherë i njëjti lëshohet për 30 ditë nga dita e aplikimit në Drejtorinë për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Ambient të Komunës në çmim prej 50 €.
- Autorizimi për hulumtim qëndron në fuqi deri sa të kalojë afati i këtij autorizimi, ose koha e caktuar në leje.
- 2.5 Të gjitha lejet e lëshuara nga Drejtoria për Miniera dhe Minerale në Prishtinë,qëndrojnë në fuqi për atë kohë që është caktuar në leje ose në kushtin e bashkangjitur në të.
- Aplikacionet nuk do të merren në konsiderim pa Pëlqimin apo Lejën e caktuar për vendveprim nga Komuna.
- 2.6 Të gjithë të licensuarit-lejuarit duhet të ushtrojnë sistemin e listave të transportimit,sikurse duhet të jenë të përshkruara në leje apo nga Komuna.
- Si shtesë ndaj kësaj: këtu përfshihet metodologjia e transportit nga rezervat e ndërmarrjes,të referuara në Aneksin A për detale plotësuese.
- 2.7 Licenca(leja)për eksploatim për nevoja personale mjeshtrorë lëshohet me miratimin nga Drejtoria Komunale për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Ambient.
- Mënyra,vendi,lloji dhe sasia e mineraleve për eksploatim(rërës,zhavorit natyror,guroret dhe matrialet tjera të gurit),do të përcaktohen në leje (duke iu referuar edhe rregullativës pozitive të autoritetit kompetent qendror) .
- Nëse miratohet nga Drejtorati,leja do të lëshohet vetëm për një ditë,ndërsa çmimi i pagesës administrative është 10 €.

Rojaliteti(qiraja për pasuritë nëntokësore)për shkak të sasisë së burimeve të eksploatuara,poashtu do të paguhet në lëshim të lejes,duke ju referuar DAL/Udhëzimi administrativ nr.2001/02 dhe Udhëzimi administrativ i AQF-ës, nr.2001/03.

Ndalimet dhe dënimet

Neni 3

- 3.1 Çfarëdo kundërvënie më nenin 2 të kësaj Rregullorës për eksploatimin e burimeve të mineraleve do të konsiderohet kundërvajtje dhe ndaj të pandehurur do të shqiptohën ndeshkimet kundërvajtse dhe masat tjera mbrojtëse:denimi,gjoha apo masa mbrojtëse varsisht nga natyra e kundërvajtjes se kryer.
- 3.2 Cilido person ose kompani që nuk e respekton nenin 2 të kësaj Rregullorje,duhet të paguajë gjobë prej :
 - 50 €,për m³ të burimeve të mineraleve të transportuara pa dokument të vlefshëm si pasues i artikullit 2.4.
 - 2.500 € për çfarëdo akti joligjor të eksploatimit të burimeve minerale dhe germues.Shumat nga alinetë e mësipërme arkëtohen në buxhetin e Komunës përmes Drejtoratit për Buxhet dhe Financa.
- 3.3 Mjetet e transportit dhe të eksploatimit të ndaluara,sipas artikullit 3.1të kësaj Rregullorje,duhet të kthehen pas pagesës së përshkruar në artikullin 3.2.
- 3.4 Shuma prej 5 € është shumë të cilën do ta paguaj secili mjet transportues, ose eksploatues.
- 3.5 Komuna disponon me burimet e mineraleve dhe me mjetet e grumbulluara nga këto burime, të cilat do të shfrytzojen me qëllim të mbrojtjes së ambientit dhe ndërtimin e infrastrukturës komunale.
- 3.6 Në rast se mjetet transportuese ose eksploatuese, nuk tërhiqen pas 90 ditëve,(përveç në rastin e përshkruar në artikullin 5.3) ato do të vëhen në ankand publik dhe shumat e mbetura pas pagesës së tarifave të papaguara,do të shfrytzojen nga Komuna, sikurse edhe pershtatet ky mendim,në mënyrë që ky lloj i zgjedhjes së çështjes të jetë në interes të përgjithshëm publik.
- 3.7 Personi,kompania ose ndonjë agjent, i cili vepron në interes të tyre, mjetet transportuese ose eksploatuese të cilit janë marrë, nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në ankand publik.
- 3.8 Për të përcaktuar ndikimin e rregullimit të ambientit të eksploatimit joligjor të burimeve të mineraleve, secili person apo kompani duhet të rregullojë vendin e eksploatimit.

Kurëdo që nuk respektohet kjo rregull për rikthimin e lokacionit në gjendjen e mëparshme pas eksploatimit, shkelësi do të paguajë gjobën prej 2500 deri 10.000 € , varësisht prej dëmit të vlerësuar.

Lidhur me kundërvajtjet e kryera inspektori për mbrojtje të ambientit dhe organi tjetër kompetent komunal si organ i autorizuar apo edhe në cilësi të personit të demtuar mund të inicoj procedurën përkatëse kundërvajtëse pranë gjykatës komunale për kundërvajtje më kompetencë reale dhe territoriale.

Implementimi

Neni 4

- 4.1 Komuna duhet të lëshojë lejen (autorizimin) nga paragrafi 2.4, si dhe lejen e eksploatimit për nevoja personale mjeshtrie, sikurse nga paragrafi 2.7.
Lidhur me lejet e lartshënuara janë të dhëna Udhëzimet nga Drejtorati për Miniera dhe Minerale këtu të bashkangjitura në Aneksin B, dhe duhet të përdoren për përcaktimin e kornizës se a do ti lëshojë Komuna këto lloje të lejeve apo jo.

Sistemi Juridik

Neni 5

- 5.1 Kundërvajtësit do të akuzohen për mospagimin e gjobës.
5.2 Kundërvajtësit mund të apelojnë në Gjykatën Komunale kompetente të Klinës.
Në rast të aprovimit të ankesës , apeluesit duhet ti kthehet shuma e gjobës së paguar, ose kur është relevante, një sasi e ngjaishme e burimeve të mineraleve, ose mjetet e konfiskuara.
5.3 Rregulla 90- ditëshe, sipas nenit 3.6 do të pezullohet në rast të ndonjë apeli pranë Gjykatës kompetente, për aq kohë deri sa Gjykata të marrë vendim.
Apeluesi duhet ti dorëzojë Komunës një kopje origjinale të dëshmisë së rregullt gjyqësore, të paktën 3 ditë para se të skadojë periudha 90- ditëshe.

Vlefshmëria

Neni 6

- 6.1 Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje e njejta do të zëvendësojë të mëparshmet, të cilat kanë rregulluar këtë çështje.
6.2 Për të gjitha çështjet të cilat nuk janë të rregulluar me dispozitat e kësaj Rregulloreje do të vlejë drejtpërsdrejti dispozitat pozitive Ligjore të autoriteteve qendrore që e rregullojnë këtë çështje.
6.3 Pjesë përberse e kesaj rregullorjeje është edhe Aneksi A dhe B.

Neni 7

Në rast të zbraktësirës tjetër juridike nga rregullativa komunale lëndore,zbatohën drejtë për se drejti dispozitat lëndore pozitive qe kanë të bejnë me burimet e mineraleve dhe mbrojtjen e ambientit,për ujrata,për xehtarin si dhe ato nga ligji për kundervajtjet.

Neni 8

Teksti i vendimit të harmoinizimit është pjesë integrale e Rregullorës komunale për eksploatimin e burimeve të mineraleve.

Hyrja në fuqi

Neni 9

7.1 Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit Komunal.

01 Nr.31-148/ 2002

Klinë , më 30 prill 2002.

KUVENDI KOMUNAL KLINË

Kryetari,



[Handwritten signature]

Duke pasur parasyshë nevojën e domosdoshme për harmonizimin e Rregullorës komunale për eksploatimin e burimeve të mineraleve më Ligjin e aplikueshëm për kundervajtjet, e me qëllim të evitimit të pengesave përkatëse praktike-juridike lidhur me implementimin dhe shqiptimin e ndeshkimeve kundervajtëse dhe masave tjera mbrojtëse që dalin nga rregullorja lëndore, si dhe të krijimit të bazës juridike të vendosjes nga ana e Gjykatës kompetente komunale për kundervajtje, Kuvendi komunal në seancën e vetë të rregullt të III-ën më radhë të mbajtur me 31 mars 2004, nxorri dhe aprovoj:

V E N D I M

I

OBLIGOHET Zyra Ligjore komunale që ta bejë harmonizimin e Rregullorës komunale për eksploatimin e burimeve të mineraleve nr.01-31-148-02 të aprovuar me 30 prillë 2002 më Ligjin e aplikueshëm për kundervajtjet („Flet.zyr.e Kosovës nr.23/79,“) si dhe me Ligjet e tjera të Kuvendit të Kosovës si atë për Mbrojtjen e mjedisit nr.2003/ si dhe me Ligjin për Planifikimin hapsinor nr.2003/30, për çështjet eventuale që nderlidhën më eksploatimin e burimeve të mineraleve.

Si udhëzues juridik mund të shfrytëzohet edhe Ligji i aplikueshëm për Xehëtarinë („Flet.zyr.e Kosovës nr.26/80,“).

II

Në rast të zbrastësires tjetër juridike nga rregullativa komunale lëndore, zbatohën drejtë për se drejti dispozitat lëndore pozitive që kanë të bëjnë me burimet e mineraleve dhe mbrojtjen e ambientit, planifikimin hapsinorë, ato që kanë të bëjnë me ujrat, më xehëtarinë si dhe ato adekuate nga Ligji i aplikueshëm për kundervajtjet.

III

Ky vendim dhe teksti i Zyrës ligjore i harmonizuar me ligjin është pjesë integrale e Rregullorës komunale për eksploatimin e burimeve të mineraleve, nderkaqë që harmonizimin dhe renditjen tekniko-juridike të dispozitave në tekstin e spastruar autorizohet ta kryej Zyra ligjore komunale së bashku me zyrtaret për mbrojtjen e ambientit.

IV

Ky vendim është i plotfuqishëm dhe hynë në fuqi nga dita e aprovimit.

V

Më vendim të njohtohën: Drejtorija komunale për bujqësi, zhvillim rural dhe mbrojtje të ambientit, një kopje mbetet pjesë integrale e Rregullorës për eksploatimin e burimeve të mineraleve, një publikohet në tabelën e shpalljeve dhe një arhiva.

01 Nr. 31-122/04

Klinë, më dt. 31 mars 2004.

KUVENDI KOMUNAL

Kryetari,
Ramë Manaj

